



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:159728

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06295610

C.nr.1450/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve K.B. me numër personal Z.B. me numër personal N.V. me numër personal Sh.K. me numër personal dhe A.Sh. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av.V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, M.F.T. si dhe M.P.B. dhe Administratë Publike, që të gjitha me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 15,316.80 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 14.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia** e paditësve K.B., Z.B., N.V., Sh.K. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- II. **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, ti paguaj shumat si në vijim:
 - Paditësit K.B. për periudhën kohore prej datës 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 2,048.50 euro;
 - Paditëses Z.B. për periudhën kohore prej datës 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 2,048.50 euro;

- Paditësit N.V. për periudhën kohore prej datës 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 78.10 euro, në shkallë prej 35% të pagës bazë- 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 2,655.40 euro;
- Paditëses Sh.K. për periudhën kohore prej datës 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 2,048.50 euro;
- Paditësit A.Sh. për periudhën kohore prej datës 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 2,048.50 euro;
-të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 21.07.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve K.B., Z.B., N.V., Sh.K. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prizreni, përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të këtij dispozitivi të aktgjykimit, dhe atë në lartësi prej 4,467.40 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 21.07.2018, apo për 14 muaj.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 412.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

V. KONSTATOHET e tërhequr padia në raport me të paditurat dhe M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, M.F.T. si dhe M.P.B. dhe Administratë Publike, që të gjitha me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësit K.B., Z.B., N.V., Sh.K. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson av.V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën

e kualifikimit ose licencimit. Me parashtrësën e datës 12.12.2022, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv, ashtu që përveç Komunës së Prizrenit, ka paditur edhe M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, M.F.T. si dhe M.P.B. dhe Administratë Publike, me seli Prishtinë.

I autorizuari i paditësve në padi, ka theksuar se paditësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë Gjimnazit "Gjon Buzuku" në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se në bazë të kualifikimit të paditësve, iu takon pagesa prej datës 18.04.2017 deri më 18.04.2021, kjo bazuar në nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017. Gjithashtu në nenin 33 pika 1.1 e UA nr.5/2017 Sistemi i Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, vazhdojnë për 5 vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, licencat e lëshuara në këto vite mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të VPM. Ndërsa për mësimdhënësit e licencuar pas vitit 2015 vlen pika 1.2 e nenit 33 të UA nr.5/2017. Bazuar në të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore, i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 21.10.2023, e paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë tërhequr padinë sa i përket të paditurave M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, M.F.T. si dhe M.P.B. dhe Administratë Publike, që të gjitha me seli në Prishtinë, si dhe kanë bërë precizimin e padisë në aspektin objektiv, ashtuqë kanë kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, që paditësve të i paguaj kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datë 18.04.2021, për paditëseve K.B., Z.B., Sh.K. dhe A.Sh. për 48 muaj nga 60.25 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,892.00 euro, për secilin nga ta, ndërsa për paditësin N.V. për 48 muaj nga 78.10 euro, apo shumën e përgjithshme prej 3,748.80 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka

kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditësve, ngase padia në gjykatë është paraqitur me datë 21.07.2021. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit K.B., Z.B., N.V., Sh.K. dhe A.Sh. që të gjithë nga Pizrreni,, janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë Gjinnazin "Gjon Buzuku" në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Nga kontrata e punës me numër protokolli 1167 e datës 15.10.2015, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës si dhe nga diploma me numër 3121 e datës 11.03.1993, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore i Prishtinës, në emër të paditësit, ku u vërtetua se paditësi Kujtim Baraliu, është i punësuar si mësimdhënës në Gjinnazin "Gjon Buzuku" në Prizren dhe vazhdon të jetë e punësuar pranë këtij institucioni. Po ashtu, u vërtetua se i njëjti ka kualifikimin shkollor-profesor i fizikës. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokolli 1229 e datës 15.10.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës si dhe nga diploma me numër 33795, e lëshuar nga Universiteti i Ankarasë, Fakulteti i Gjuhës dhe Histori-Gjeografisë, në emër të paditëses, ku u vërtetua se paditësja Z.B. është e punësuar si mësimdhënëse në Gjinnazin "Gjon Buzuku" në Prizren dhe vazhdon të jetë e punësuar pranë këtij institucioni. Po ashtu, u vërtetua se e njëjta ka kualifikimin shkollor-bachelor në filologji. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokolli 864 e datës 07.04.2017, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës si dhe nga diploma me numër 5 e datës 09.10.2017, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, në emër të paditësit, ku u vërtetua se paditësi N.V. është i punësuar si mësimdhënës në Gjinnazin "Gjon Buzuku" në Prizren dhe vazhdon të jetë e punësuar pranë këtij institucioni. Po ashtu, u vërtetua se i njëjti ka kualifikimin shkollor-Master në shkenca kompjuterike dhe teknologji komunikimi. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga

Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Mr.Dr, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 82.55 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokolli 191 e datës 15.09.2016, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës si dhe nga diploma me numër 16, e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Filologjisë, në emër të paditëses, ku u vërtetua se paditësja Sh.K. është e punësuar si mësimdhënëse në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren dhe vazhdon të jetë e punësuar pranë këtij institucioni. Po ashtu, u vërtetua se e njëjta ka kualifikimin shkollor-bachelor në gjuhë dhe letërsi gjermane. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Nga kontrata e punës me numër protokolli 1137 e datës 15.10.2015, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës si dhe nga diploma me numër 2752 e datës 25.05.1990, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore i Prishtinës, në emër të paditësit, ku u vërtetua se paditësi A.Sh. është i punësuar si mësimdhënës në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren dhe vazhdon të jetë e punësuar pranë këtij institucioni. Po ashtu, u vërtetua se i njëjti ka kualifikimin shkollor-profesor i fizikës. Ndërsa nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se lartësia e pagës bazë të paditësin është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se "shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të". Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që "nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit". Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se "mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%". Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023,

në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 63.80 euro për çdo muaj, paditësve K.B., Z.B., N.V., Sh.K. dhe A.Sh. ndërsa paditësit N.V. ia ka paguar shumën prej 82.55 euro për çdo muaj. Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit K.B., Z.B., Sh.K. dhe A.Sh. ç, S përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 123.93 euro ndërsa paditësi N.V. përfitonë ngritje prej 35% të pagës bazë apo 160.65 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve K.B., Z.B., Sh.K. dhe A.Sh. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 60.25 euro, për 34 muaj nga data 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021, në shumë të përgjithshme prej 2,048.50 euro për secilin nga ta, ndërsa paditësit N.V. nga data 21.07.2018 deri më datë 18.04.2021, për 34 muaj apo nga 78.10 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,655.40 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 21.07.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 21.07.2021, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 21.07.2018. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 14 muaj apo në shumën prej 4,467.40 euro, ndërsa paditësit kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata vendosi si në pikën V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenit 261 par.3 e lidhur me nenin 387 par.1 nën par.c), të LPK-së, duke e konstatuar të tërhequr padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në raport me të paditurat M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, M.F.T. si dhe M.P.B. dhe Administratë Publike, që të gjitha me seli në Prishtinë, pasi që paditësit përmes të autorizuarit të tyre me parashtresën e datës është tërhequr nga kërkesëpadia në raport me këto dy të paditura.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 412.00 euro, sipas kërkesës së paditësit, për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 100.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtresë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtresën e dorëzuar për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtresa gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1450/2021 të datës 14.10.2024

G j y q t a r i

Numri i lëndës: 2021:159728
Datë: 14.10.2024
Numri i dokumentit: 06295610

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.